



# - SALSTAT -

## BULETIN INFORMATIV

STATISTIKA TË FORTA VENDORE SHQIPTARE

Tetor 2022 – Mars 2023

Projekti për "Statistika të forta vendore shqiptare", SALSTAT II është pjesë e projektit ombrellë "Bashki të Forta" të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), për periudhën Tetor 2022 - Shtator 2026. Puna e projektit "Bashki të Fortë" përqendrohet në aspekte të ndryshme të zhvillimit vendor të Shqipërisë, me qëllim mbështetjen e decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Palët kyç të projektit janë INSTAT-i, bashkitë dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, në veçanti ato që kanë për detyrë të mbledhin të dhëna statistikore dhe/ose janë përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë.

Gjatë fazës së re, SALSTAT II do të intensifikojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare për të forcuar besimin te statistikat zyrtare, si dhe do të angazhohet në një diskutim me palët e interesit rreth përfitimeve që statistikat zyrtare sjellin për qeverisjen demokratike dhe procesin e vendimmarrjes, në veçanti për përmbushjen e detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të bashkisë.

## Përmbajtja:

- Publikimi i vjetarit statistikor rajonal 2022
- Prezantimi i vjetarit statistikor për qarqet dhe bashkitë
- Sinergia mes SALSTAT dhe HELVETAS: Bashki të Forta
- Zhvillimi i një koncepti për panelin dixhital
- Plani i veprimit për vitin 2023 i SALSTAT/ INSTAT
- Regjistri statistikor i ndërtesave dhe banesave në Shqipëri
- Seminar me personelin e zyrave rajonale statistikore
- Trajnim i personelit të bashkive për anketën e menaxhimit të mbetjeve shtëpiake
- Trajnim i personelit të zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e cilësisë së statistikave demografike (treguesit demografikë)
- Takimi me Shoqatën për Autonominë Vendore të Shqipërisë (SHAV).

## Publikimi i vjetarit statistikor rajonal 2022

Përfundoi puna për Vjetarin Rajonal 2022 (qarqet dhe bashkitë). Vjetari Rajonal u publikua më 29 dhjetor 2022, në gjuhën angleze dhe shqip. Më poshtë janë lidhjet përkatëse:

<http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2022/regional-statistical-yearbook-2022/>

<http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2022/vjetari-rajonal-statistikor-2022/>

Nëse dëshironi të merrni një kopje të vjetarit, lutemi të kontaktoni SALSTAT-in me anë të postës elektronike.

## Prezantimi i vjetarit statistikor për qarqet dhe bashkitë

Rezultatet e Vjetarit Statistikor Rajonal 2022, u prezantuan në një aktivitet të zhvilluar më 8 shkurt 2023, në ambientet e hotel "Tirana Internacional", në Tiranë.



## Sinergjia mes SALSTAT dhe HELVETAS – Bashki të Forta

Në kuadër të sinergjisë mes dy projekteve SALSTAT II dhe HELVETAS, mbahen takime të rregullta mujore me qëllim shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve.

Me rastin e nisjes së punës, u mbajt një takim mes të dyja ekipeve më 20 tetor 2022. U zhvilluan diskutime rreth bashkëpunimit për statistikën e menaxhimit të mbetjeve shtëpiake dhe sektorin e ri të bashkëpunimit, d.m.th. arsimit parashkollor.



## Zhvillimi i një koncepti për panelin dixhital (dashboard)

Më 15 dhjetor 2022, u mbajt në ambientet e INSTAT-it një takim për nisjen e punës për panelet dixhitale, si dhe përfshirjen në internetin dhe intranetin e INSTAT-it me qëllim shpërndarjen e statistikave për qarqet dhe bashkitë.



## Plani i veprimit për vitin 2023 i SALSTAT/ INSTAT

Një seminar njëditor u zhvillua më 22 nëntor 2022, në sallën "Stokholm" të Hotel Rogner. Personeli i INSTAT-it, ekipi i SALSTAT II-shit dhe përfaqësues të SDC-së morën pjesë në seminar. Qëllimi kryesor ishte të diskutohej plani i aktiviteteve për vitin 2023, si dhe hapat e mëtejshëm. Më poshtë paraqitet agjenda e seminarit njëditor të mbajtur në hotel Rogner, Tiranë:

- ✓ Prezantimi i aktiviteteve të planit vjetor 2023: rezultati 1, rezultati 2 dhe rezultati 3
- ✓ Mësimet e nxjerra nga faza e parë e projektit SALSTAT
- ✓ Diskutime rreth ndikimeve të rreziqeve si: zgjedhjet vendore, Censusi, burimet njerëzore, etj.
- ✓ Diskutime rreth ngjarjeve të ardhshme të planifikuara për muajin shkurt 2023 (aktiviteti RY) dhe maj 2023 (aktiviteti SDG)



## Regjistri statistikor i ndërtesave dhe banesave në Shqipëri

Në kuadër të projektit SALSTAT, INSTAT-i zbaton projektin e regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave në Shqipëri (RSNB). Gjatë kësaj periudhe, eksperti punoi me sektorin e gjeo-informacionit (GIS) për të dhënat e mbledhura gjatë fazës pilot të RSNB-së për të analizuar mundësinë e të dhënave gjeografike nga burime të ndryshme: të dhënat pilot 2021 (ndërtesat, hyrjet, banesat); dhe të dhënat e adresave nga sistemi i adresave të Zyrës së Gjendjes Civile; krijimi i tabelës së referencës për RSNB-në "emër rrugë" për t'u zbatuar në censusin e vitit 2023.

Përgjatë periudhës nëntor 2022- mars 2023, eksperti zhvilloi dy misione në INSTAT. Mbajti takime dhe diskutoi me departamentin e IT-së, zyrën ligjore dhe ekipin e GIS-it të INSTAT-it.

Njësia e GIS-it, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertin ndërkombëtar, arriti disa objektiva: u standardizuan emrat zyrtarë të rrugëve për të bërë lidhjen mes tabelave për zbatimin e regjistrit dhe të dhënave për përditësimin e hartës. U trajtuan të dhënat pilot për të qenë gati për ngritjen e bazës së të dhënave pilot për regjistrin.




Gjatë muajit mars 2023, eksperti dhe ekipi i GIS-it zhvilluan një takim në nivel teknik, për shkëmbimin e përvojave me Departamentin e Sistemit Kombëtar të Adresave, të Ministrisë së Brendshme.



## Seminar me personelin e zyrave rajonale statistikore

Në dhjetor 2022, u organizua një seminar me zyrat rajonale të INSTAT-it në lidhje me:

- ✓ Prezantimin e kalendarit të anketave/ vrojtimeve 2023;
- ✓ Demonstrimin e sistemit të monitorimit;
- ✓ Prezantimin e sistemit CATI (sistemi i asistuar nga kompjuteri për zhvillimin e intervistës telefonike);
- ✓ Intranet - zyrat rajonale/ përditësimi me dokumentacionin e nevojshëm.



## Trajnim i personelit të bashkive në lidhje me anketën e menaxhimit të mbetjeve shtëpiake

Gjatë muajit shkurt 2023, së bashku me Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit të INSTAT-it, SALSTAT-i përfundoi procedurat e nevojshme administrative, përfshirë këtu edhe njoftimin zyrtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për trajnimin e bashkive dhe zyrave rajonale statistikore për plotësimin e anketës për mbetjet shtëpiake.

Për secilin grup u zhvillua një trajnim dyditor përkatësisht më 20 - 21, 23-24 dhe 27-28 shkurt 2023, në ambientet e Hotel Diplomat, sipas agjendës së mëposhtme:

- ✓ Statistikat urbane të bashkive (INSTAT).
- ✓ Problemet e hasura nga bashkitë gjatë vitit të kaluar në lidhje me konceptin dhe mbledhjen e të dhënave (INSTAT)
- ✓ Metodologjia e mbledhjes së këtyre të dhënave (INSTAT)
- ✓ Aplikacioni për mbledhjen e të dhënave (eksperti IT-së INSTAT-it)
- ✓ Metodologjia e mbledhjes dhe prodhimit të të dhënave për mbetjet, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538/2021 (eksperti i Helvetas)

Gjithsej, 63 punonjës morën pjesë në trajnime, ku 31 ishin punonjësë gra (ose 49% e totalit të pjesëmarrësve). Në trajnim morën pjesë gjithashtu edhe 19 punonjës nga 17 zyra rajonale statistikore. Si përmblendje, 82 pjesëmarrës përfunduan trajnimin.

Në trajnim morën pjesë edhe punonjës nga 46 bashki (ose 75 % e totalit të bashkive).

Lidhja e faqes online të anketës iu dërgua të gjitha bashkive dhe sektori i statistikave të mbetjeve mbështet punonjësit e bashkive për të plotësuar online anketën për menaxhimin e mbetjeve shtëpiake.

Nëse do të jetë e nevojshme, do të ofrohet ndihmë në terren nga INSTAT-i, në veçanti nga stafi i zyrave rajonale të INSTAT dhe SALSTAT, për të pasur të dhëna cilësore për menaxhimin e mbetjeve shtëpiake nga të 61 bashkitë.



## **Trajnim i personelit të zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e cilësisë së statistikave vitale (treguesit demografikë)**

Në korrik 2022, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) nënshkruan një memorandum mirëkuptimi.

Në zbatim të këtij memorandumi, do të organizohen një seri trajnimesh me qëllim zhvillimin e kapaciteteve në drejtim të përmirësimit të cilësisë së statistikave demografike në nivel vendor, si dhe regjistrimin e përgjithshëm të treguesve demografikë dhe kuadrin ligjor. Nga ana logjistike, trajnimet u mbështetën nga projekti SALSTAT.

Në periudhën gusht-shtator 2022, u zhvilluan dy trajnime pilot me të gjithë punonjësit e zyrave të Gjendjes Civile të Qarkut Korçë dhe Shkodër. Pas vlerësimit të të dhënave të mbledhura për këto dy qarqe nga Drejtoria e Statistikave Sociale të INSTAT-it, u arrit në përfundimin se kishte përmirësime në regjistrimin e variablave të treguesve demografikë.

Në bazë të memorandumit të mirëkuptimit dhe pas vlerësimit, u ra dakord që trajnimet për zyrat e Gjendjes Civile (ZGJC) të vazhdojnë. Deri më tani, janë zhvilluar katër trajnime për ZGJC-të e qarkut Tiranë, përkatësisht më 27 -28 mars, 29 - 30 mars, 11 -12 prill dhe 13 -14 prill 2023.

Në aktivitetin e hapjes, ishte e pranishme Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT-it, znj. Elsa Dhuli dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPGJC-së, z. Vangjush Stavro. Të dy vunë theksin mbi bashkëpunimin pozitiv mes dy institucioneve dhe vlerësuan mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, përmes projektit SALSTAT.



Ndër temat kryesore që u diskutuan gjatë trajnimit ishin: rëndësia e trajnimit, sistemi kombëtar statistikor, kuadri ligjor për regjistrin e gjendjes civile dhe treguesve demografikë, mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave vitale nga DPGJC-ja, etj.



Në qendër të diskutimeve ishte identifikimi i problemeve, si hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së të dhënave demografike. Kjo u bë e mundur duke analizuar statistikën vitale dhe proceset që ndjek INSTAT-i në lidhje me pastrimin e dublikatave, të dhënat që mungojnë, zëvendësimin (imputimin) e të dhënave, vlerat ekstreme dhe nevojën për të shtuar variabla.

Gjithashtu, u diskutuan me hollësi problemet që hasen në regjistrimin e vdekjeve. INSTAT-i propozoi shpërndarjen e listës së kodeve të sëmundjeve dhe përshkrimin e sëmundjeve sipas klasifikimit statistikor ndërkombëtar të sëmundjeve dhe problemeve që lidhen me shëndetin (ICD 9 dhe ICD 10).

## Takimi me Shoqatën për Autonominë Vendore të Shqipërisë (SHAV).

Gjatë muajit mars 2023, u zhvillua një takim ndërmjet ekipit të projektit SALSTAT dhe znj. Adelina Farrici, Drejtoreshë e Ekzekutive e Shoqatës për Autonominë Vendore të Shqipërisë, si pjesë e Komitetit Drejtues të SALSTAT.

Në këtë takim, u diskutua për mundësinë e një bashkëpunimi të mundshëm me personelin e bashkive dhe nevojat e tyre për trajnime. Një ndër interesat kryesore të bashkive është të kenë të dhëna në nivel bashkie për t'i ndihmuar të realizojnë detyrat e tyre. Përveç kësaj, pasja e bazave të sakta të të dhënave do të udhëheqë bashkitë në zhvillimin e tyre.

U diskutua gjithashtu ideja e krijimit të një manuali për trajnimet, të cilit bashkitë mund t'i referohen gjatë punës së tyre të përditshme.

Njëtrajtshmëria e të njëjtit personel në trajnimet që lidhen me të dhënat statistikore është e rëndësishme për bashkitë, në mënyrë që ato të jenë të afta të mbledhin të dhënat e duhura. Hapi i mëtejshëm është përzgjedhja e bashkive pilot për trajnimet.

Znj. Farrici konfirmoi se do të mbështesë projektin në komunikimin me bashkitë.

### FALEMINDERIT NGA EKIPI I PROJEKTIT SALSTAT!

#### **Menaxher i projektit:**

Martin Teichgraeber, Zyra Federale e Statistikave të Zvicrës

#### **Koordinatorët:**

Eralda Pushaj, Koordinatorë për Njësitë Qendrore të Qeverisjes

Edlira Çeliku, Koordinatorë për Çështjet Administrative dhe Financiare

Alketa Doçi, Koordinatorë për të Dhënat dhe Regjistrat Administrativë